



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:198224
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05342395

KPPP.nr. 2179/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.U “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala” nr.4, kundër debitorit M.L. Caffè Bar Ruho, me seli në Prishtinë, rr. “Flaka e Janarit” Q-T-I-6, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 101/2021 të datës 02.03.2021, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit M.L. Caffè Bar Ruho, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 101/2021 i datës 02.03.2021, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K.R.U “Prishtina” Sh.A., me datë 02.03.2021 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 101/2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën 91102, duke detyruar debitorin, në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara për shërbimet e furnizimit me ujë, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 675.79 EUR, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se borxhi i kërkuar me propozimin për përmbartim është i parashkuar në tërësi,

ndërsa borxhi deri në vitin 2020 është paguar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar si dhe të shfuqizohet urdhri për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit kjo pasi që debitori ka bërë vazhdimisht pagesa, e rrjedhimisht i njëjti veçse ka pohuar borxhin ndaj kreditorit, fakt ky që ndikon në ndërprerjen e afatit të parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr. 901/2021 të datës 01.08.2022 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr. 101/2021 të datës 02.03.2021 në vlerë prej 420.71 EUR për shkak të parashkrimit të kërkesës, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor në shumën prej 255.08 EUR.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin Kom.DH.Shk.II.nr. 913/23 të datës 22.11.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 901/2021 të datës 01.08.2022, ndërsa lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate përmes aktvendimit Kom.DH.Shk.II.nr. 913/23 të datës 22.11.2023, në mbështetje të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën 91102 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit dhe nuk është përfshirë periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Deri tek ky vlerësim Gjykata erdhi pasi që me propozimin për përmbarim, borxhi i kërkuar në shumë prej 675.79 EUR është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 e deri më datë 01.03.2021, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, evidentohen faturat vetëm nga periudha 31.12.2013 e tutje, kështu duke mos u përfshirë fare faturat dhe borxhi nga data 01.01.2013 e deri më datë 13.12.2013.

Si rezultat i kësaj, saldo e identifikuar në përmbajtjen e kësaj karteje në vlerë prej 2,008.33 EUR nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar, e rrjedhimisht, në mungesë të qartësisë së objektit të përmbarimit, dokumenti i lartcekur rezulton të mos ketë tipare të përmbarueshmërisë dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Meqenëse dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi përmban të meta formale nga neni 29, par.3 i LPP-së, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të natyrës materiale të ngritura nga debitori në prapësim, e si rrjedhojë, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2179/22 datë 16.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.